


# MJEDISI SOT

Botim i përmuajshëm i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) - Shqipëri

## EDUKIMI MJEDISOR

Paketa e Gjelbër gjen rrugën në sistemin arsimor shqiptar



**Edukimi mjedisor sot për të ardhmen e pastër nesër**

*lexoni në faqen 7*



**Mund të bëhen nxënësit aktivë për mbrojtjen e mjedisit?**

*lexoni në faqen 14*



**Trajnime për mësuesit**

*lexoni në faqen 5*

## MJEDISI SOT

është një botim periodik i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Zyra në Shqipëri

Në këtë botim të përmuajshëm do të gjeni informacion për probleme mjedisore, lajme të përzgjedhura, opinione e komente për çështje të mjedisit nga vendi dhe rajoni, informacione për aktivitete për mjedisin nga vendi dhe bota etj.

Versionin elektronik të kësaj reviste mund ta gjeni në faqen: <http://albania.rec.org>

Për të marrë “Mjedisit Sot”, e përditshme elektronike, me postë elektronike apo revistën “MJEDISI SOT” (botim i përmuajshëm), dërgoni emrin dhe adresën tuaj pranë Zyrës së REC në Shqipëri, në adresat:

Kutia Postare 127, Tiranë;

Tel/Faks: (04) 23 29 28;

ose [editor@albania.rec.org](mailto:editor@albania.rec.org)

<http://albania.rec.org>



**QENDRA RAJONALE E MJEDISIT**  
Shqipëri

## Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)

*për Europën Qendrore e Lindore*

është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, jo-vokate, jofitimprurëse, që mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Europën Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimarrjen mjedisore. REC është krijuar në 1990 nga SHBA, Komisioni Europian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjërisht në Kartën e tij, nënshkruar nga 28 vende dhe nga Komisioni Europian, dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari, dhe zyrat e vendeve në secilin prej 15 vendeve përfutuese. Shqipëria e ka nënshkruar Kartën e REC në 1993. Zyra e REC për Shqipërinë është hapur në 1994. Kjo zyrë punon për realizimin e misionit të REC duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, institucionet mjedisore në të gjitha nivelet dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e mjedisit, duke mbështetur proceset pjesëmarrëse dhe shkëmbimin e lirë të informacionit. Fushat kryesore të veprimtarisë janë: Programi i granteve për OJF-të; Planet Lokale të Veprimit në Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit për OJF-të dhe zyrtarë të mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale etj. Donatorët më të fundit janë: Komisioni Europian, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, SIDA, UNDP, GEF/SGP, Fondacioni SOROS, SDC, BE, etj.

<http://albania.rec.org>

EDITORIAL	3
(S)A duhet të mësojmë për mjedisin?	
NGA VENDI	3-4
Shkodër, sëmundje lëkure nga papastërtitë e ujit Prerja e drurëve, fenomeni që dëmton pyjet Siguria ushqimore në projekt-ligjin e ri të ushqimit Gjallesat në rrezik - Dita Botërore e Habitateteve	
NGA REC	5
Trajnime me mësuesit për Paketën e Gjelbër Thirrje për projekt ide në kuadër të programit SECTOR	
PROFIL SEARCH	13
NGA BOTA	13-15
Raporti i BE për produktet me ndikim të lartë në mjedis Pse edukimi mjedisor Kombet e Bashkuara do të studiojnë mjedisin në Liban	
OPINION	14
Mund të bëhen nxënësit aktivë për mbrojtjen e mjedisit?	
TEMA E MUAJIT	7-12
Edukimi mjedisor sot, për të ardhmen e pastër nesër Loja me dilemat Fëmijët duan të edukohen mbi mjedisin Nevoja për Edukimin Mjedisor Kanë thënë për Paketën e Gjelbër	



Ky botim mbështetet financiarisht nga  
Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri

### Kanë kontribuar për këtë numër:

Brikena Demiras | Dhimitër  
Haxhimihali | Ina Kasimati | Lindita  
Bushati | Liri Dinga | Lirim Selfo |  
Robert Atkinson | Shefqet Xhanari |  
Tefta Musta | Xhemal Mato

### Stafi Editorial

Mihallaq Qirjo | Alken Myftiu |  
Brikena Demiras | Genta Hoxha |  
Eduart Cani | Daniela Tola



## (S)A duhet të mësojmë për mjedisin?

“Ti pastron e unë bëj pis, se ti ke radhën e pastërtisë”. Të gjithë e kemi parë Çufon dhe Tipin, dy personazhet e teatrit me kukulla për fëmijë. Që fëmijë ne na janë dhënë modele sjelljesh, të cilat i kemi mësuar jo vetëm në shkollë, por edhe në jetën e përditshme.

Bashkë me ne është rritur edhe kjo mënyrë të vepruari, është brumosur në mendjen dhe ndërgjegjen tonë dhe e tillë do të vazhdojë të mbetet deri me shuarjen tonë. Ato që mësohen shpejt, sipas studimeve të shumta të kësaj fushe, zor se harrohen kollaj. Njerëzit i kujtojnë madje me nostalgji dhe i rifreskojnë kujtimet e tyre herë pas here që të mos i harrojnë. E tillë është qenia njerëzore dhe e tillë është jeta. Prandaj edhe theksi duhet të vendoset, mbi të gjitha, te format e përhapjes së mesazheve të rëndësishme, kohën dhe momentin e duhur. I tillë është edukimi mjedisor. Përveçse një domosdoshmëri, është një element që duhet të rritet bashkë me njeriun. Sa më në embrion të tij të themelohet si njeri, mik me natyrën, aq më e mirë do të jetë bota, e ardhmja jonë dhe gjithë rruzulli tokësor.

Edukimi mjedisor është një proces i qëndrueshëm për shoqërinë, i cili e bën atë të vetëdijshëm për mjedisin e tij. Edukimi mjedisor shpërndan mesazhet në momentin e duhur duke i dhënë mundësi kujtdo që të fitojë njohje, vlera, përvoja e të veprorë individualisht e kolektivisht për të zgjidhur problemet e së tashmes dhe të ardhmes së mjedisit. Specialistë dhe studiues të mjedisit e kanë përcaktuar edukimin mjedisor si “kërkesë të kohës”. Shfrytëzimi i natyrës nga ana e njeriut, sidomos në Shqipëri, tashmë nuk shihet më vetëm si shprehje e aftësisë për të përfutur sa më shumë si dhe për të rritur mirëqenien, por edhe si përgjegjësi më e madhe që ecën paralelisht me fitimin e të mirave materiale. Nëpërmjet këtij edukimi transmetohet dashuri dhe kujdesje për natyrën, përmes procesit të të mësuarit, sepse njeriu jeton në çdo kohë në simbiozë me natyrën. Ndryshimet që kanë ndodhur në të gjitha sferat e jetës shqiptare kanë pasur edhe ndikimin e tyre në mjedis, por kërkojnë edhe përbalimin e problemeve të shfaqura, nevojitet ndërgjegjësimi i komunitetit për domosdoshmërinë e mbrojtjes së mjedisit. Njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm që mbijetesa e mjedisit tonë natyror varet drejtpërdrejt nga sjellja e tij. Çdo e keqe që ne i shkaktojmë mjedisit që na rrethon, të paktën në vendin tonë, është vënë re se vjen për shkak të mosnjohjes së rrezeve, abuzimit dhe gjithçka e ka bazën te komuniteti. Sa më shumë modele negative që ta rrethojnë atë, aq më shumë do të ndikohet edhe ai në sjellje. Ndikimi negativ i njeriut në natyrë, ndryshimi i mënyrës së të jetuarit dhe sjelljes ndaj mjedisit është pranuar se sjell rreze dhe pasoja afatgjata të parikuperueshme në gjithë treguesit e jetës. Ndryshimi i modeleve, me anën e futjes së paketave mësimdhënëse siç është Paketa e Gjelbër do të sjellë, pa diskutim, ndryshimin e mentalitetit, sepse duke mësuar për mjedisin, do të mësojmë ta duam më shumë atë dhe veten.

# Shkurt

## Shkodër, sëmundje lëkure nga papastërtitë e ujit

Ndonëse prej 1 viti nuk pijnë nga uji i çezmave për shkak të ndotjes, pasojat e tubacioneve të çara po shfaqen nëpërmjet sëmundjeve të lëkurës. Banorët e lagjes “Dobraç”, prej muajsh, ankohen për gjendjen e rëndë të krijuar në këtë zonë, e megjithatë ndërmarrja e ujësjellësit nuk u ka ofruar ndonjë zgjidhje edhe kur vetë banorët kanë dalë vullnetarë për shpenzimet. Në këtë lagje jetojnë 40 familje, të cilat detyrohen që pavarësisht ndotjes së ujit, të lajnë enët, rrobat apo të bëjnë dush, duke blerë ujin e pijshëm. Për shkak të tubacioneve të çara, në rubinetat e shtëpive të tyre uji sjell dhe papastërti të shumta. Shqetësimi është bërë edhe më i madh këto ditë, kur te banorët janë shfaqur shenja të sëmundjeve të lëkurës. Selë Zyberi, njëri prej familjarëve të lagjes “Dobraç”, thotë se kjo gjendje është e pranishme prej një viti. “Prej shumë muajsh po ndeshemi me fenomenin e ndotjes së ujit të pijshëm dhe askush nuk ka treguar interes për të riparuar tubat e çarë”-thotë ai.

## Prerja e drurëve, fenomeni që dëmton pyjet

Vetëm gjatë pjesës së parë të vitit, sipas statistikave të Ministrisë së Mjedisit, rreth 7 789 drurë, me një vëllim 1 467 metër kub, janë prerë në pyjet e vendit tonë. Në krahasim me një vit më parë, edhe pse është vënë një përmirësim i fenomenit, me një shifër rreth 60 për qind më të ulët, ende ka nevojë për shtimin e kontrollit për parandalimin e tij. Për këtë qëllim, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është përqendruar kryesisht në forcimin e disiplinës në punë dhe rritjen e prestigjit të punonjësve të Policisë Pyjore, aplikimin e sanksioneve të ligjit të ri të pyjeve nga zonat pyjore deri në qendrat e përpunimit dhe shitjes së lëndës drusore, forcimin e kontrollit në aktivitetin e gjuetisë sportive dhe turistike.

# Siguria ushqimore në projektligjin e ri të ushqimit

Siguria ushqimore është një ndër çështjet më të mëdha të Shqipërisë, aq më tepër kur konsumatorët shqiptarë as nuk lexojnë etiketat e produkteve në treg, ku falsifikimi dhe prodhimi ilegal i ushqimeve është një industri e tërë. Në Ditën Botërore të Ushqimit, atëherë kur autoritetet, organizatat e biznesi i ushqimeve apo i konsumatorëve duhej të ishin bashkë, ata janë të ndarë. Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve organizoi me rastin e kësaj dite një diskutim me pedagogë dhe studentë të Universitetit Bujqësor për projektligjin e ri të ushqimit për çështjen e sigurisë ushqimore. Ai është dërguar prej kohësh në qeveri për miratim, megjithëse duhet të ishte diskutuar më parë me trupat akademike. ZMK është e shqetësuar për mungesën e pjesëmarrjes së konsumatorëve në debatet mbi ushqimin dhe politikat e sigurisë ushqimore, të organizuara deri më tani nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së



Konsumatorëve, (siç është rasti i sigurisë ushqimore në kohën e turizmit, vendosja e etiketave të produkteve, siguria ushqimore), prandaj ka hapur një cikël debatesh mbi këtë problem. ZMK konstaton se debati mbi ushqimin dhe sigurinë ushqimore është një çështje e ditës, e cila ka nevojë të mos trajtohet më vetëm si një çështje e brendshme e institucioneve. Mentaliteti që siguria ushqimore është një çështje e brendshme e raportit. autoritete – biznes ushqimesh është jashtë kontekstit të MSA-së




dhe jashtë çdo konteksti demokratik të raportit shtet - publik. Në të gjithë botën, siguria ushqimore është një çështje debati midis autoriteteve, biznesit dhe konsumatorëve. Edhe vetë Projektligji i Ushqimit është i vetmi në Evropë që nuk parashikon pjesëmarrjen e konsumatorëve në vendimmarrje: Bordi i Ushqimit nuk parashikon përfaqësues nga konsumatorët, por vetëm nga organizatat e biznesit.

## Gjallesat në rrezik!

Llojshmëria e gjallesave në Shqipëri përfaqëson rreth 30 për qind të florës evropiane, por ato nuk janë të mbrojtura. Ato ndodhen në prag të shkatërrimit të tyre. Prej shumë vitesh tashmë, diversiteti i ekosistemeve dhe habitateve në pyje, në zonat e mbrojtura, në ujërat e deteve ose liqeneve dhe në rezervuare, është nën presion të dëmtimeve që janë shkaktuar nga vetë njerëzit. Në Ditën Botërore të Habitaveve, 6 tetor, specialistët e mjedisit vunë theksin në rëndësinë që ka mbrojtja e kësaj pasurie të rrallë për vendin tonë. Sipërfaqe të mëdha numërohen sot me pyje të djegura ose të sëmura. Specialistët shpesh kanë ngritur zërin për humbjen e mjediseve natyrore bregdetare, mjediseve të pushimit, habitateve ushqimore dhe të riprodhimit, faktorë që kanë shtyrë kafshët dhe shpendët e rrallë të largohen nga zona të tëra banimi. Një faktor i rëndësishëm është edhe varfërimi i habitateve që është pasojë e tej shfrytëzimit të prodhimeve të dyta si; të pyllit ashtu edhe të kullotave, kjo si për florën ashtu edhe për faunën. Ka të tjerë faktorë që në pjesë të ndryshme të vendit kanë ndikuar në shkatërrimin e habitateve. Të tillë janë zhvillimi pa kriter i turizmit bregdetar, peshkimi dhe gjuetia pa kriter që kanë sjellë dëme të konsiderueshme në zonat pyjore, kullotat, rezervat, lumenj e liqene, ndërhyrjet e vazhdueshme nga njeriu në ekosistem, ndërtime pa leje në zona të veçanta, shkarkimet e ujërave të zeza.



**6 Tetor  
Dita Botërore  
e Habitaveve**



# Gjatë muajve Tetor-Dhjetor 2006




QENDRA RAJONALE E MJEDISIT  
Shqipëri

organizon:

## trajnime me mësuesit mbi Paketën e Gjelbër

*në kuadër të edukimit mjedisor në shkollë*



## SECTOR

Mbështetje për organizatat e Shoqërisë Civile  
në Evropën Juglindore

**10 Nëntor 2006**  
**Afati për raundin e parë**  
**të paraqitjes së projekt-ideve**

Udhëzuesin dhe formularët e aplikimit mund ti gjeni në internet, në:  
<http://albania.rec.org/Projects/SECTOR/sector.html>



Ky program grantesh mbështetet nga  
Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)

të mësojmë  
t'i duam



**...në harmoni me natyrën**

# Edukimi mjedisor sot për të ardhmen e pastër nesër

**Paketa e gjelbër në Shqipëri, një praktikë e mirë e edukimit mjedisor**

Një mësues i mirë është një nxënës i përjetshëm. Kjo është edhe mënyra më praktike e të mësuarit dhe tejçimit të njohurive nga njëri brez te tjetri. Mes qëllimeve të tjera, ky parim mbetet edhe motoja kryesore e “Paketës së gjelbër”, paketa edukative për fëmijët e shkollave 9-vjeçare, që do të jetë pjesë e orëve mësimore këtë vit shkollor. Paketa e Gjelbër është një praktikë e mirë edukimi, e studiuar dhe provuar në vende të tjera, e cila formon vlera të reja te nxënësit. Por jo vetëm kaq. Ajo ngre një model të ri sjellje në shkollë, shtëpi dhe shoqëri, një praktikë që fëmijët mund ta ‘përtypin’ më lehtësisht. Ajo nuk është thjesht një përmbledhje njohurish në fushat e mjedisit. Nxënësit janë partnerë me mësuesit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, diskutime e vendimmarrje. Mesazhet kryesore të kësaj pakete shpërndahen nëpërmjet nxënësve dhe mësuesve, në mënyrë shumë efektive dhe tek anëtarët e tjerë të familjes dhe shoqërisë. Duke marrë parasysh se edukimi nuk është thjesht një nga të drejtat e njeriut, nuk duhet të mohojmë edhe faktin tjetër që arsimimi mbi mjedisin shihet si një parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm. Vlerat, mënyra e jetesës dhe qëndrimi janë sjellje që edukohen në fëmijërinë e hershme, prandaj edhe roli i mësimdhënies merr përmasat e një rëndësie të veçantë për fëmijët. Edukimi i fëmijëve të moshës 11-15 vjeç me mesazhet e mbrojtjes së mjedisit është një garanci për të ardhmen dhe një shpresë se do të zhvillojnë gjithnjë një mjedis më të pastër.

## Paketa e Gjelbër në Evropë

Në vitin 2000, REC i paraqiti Toyotës idenë e një programi për mbështetjen e edukimit mjedisor në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të një pakete edukative për fëmijët e shkollave, të moshave 11-15 vjeç. Projekti i quajtur “Paketa e Gjelbër” - “Green Pack”, propozuar nga REC filloi në Poloni si vendi i parë pilot. Më tej, u shtri në Slloveni, Serbi dhe Malin e Zi, Rumani dhe Estoni. Zhvillimi i versionit anglisht të Paketës së Gjelbër i mbështetur nga




## Struktura dhe përmbajtja

Paketa e Gjelbër është një kurrikulum i edukimit mjedisor i nivelit mesatar kryesisht për fëmijë, i orientuar për mësuesit e shkollave tetëvjeçare evropiane dhe nxënësit e tyre, megjithatë ai mund të përdoret dhe nga nivelet e tjera të arsimit. Ai fokuson, në mënyrë të veçantë, aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshin një numër të madh materialesh edukative siç është libri i mësuesit së bashku me planin e leksioneve dhe fletët informuese për studentët, disk DVD me filma të shkurtër vizatimorë dhe edukativë, CD me informacion më të zgjeruar mbi temat mjedisore si dhe lojërat e dilemave. Zhvillimi i Paketës së Gjelbër është bërë i mundur falë bashkëpunimit dhe dëshirës së mirë të shumë individëve dhe organizatave që kanë kontribuar në përmbajtjen e tij. Për përgatitjen e përmbajtjes së kësaj pakete kanë punuar një numër i madh ekspertësh, metodistësh nga Instituti i Kurikulës dhe standardeve, mësuesish kryesisht nga shkollat e Tiranës, pedagogësh nga universiteti i Tiranës dhe institucione të tjera shkencore arsimore, ndërkohë që për përgatitjen e CD-së kanë kontribuar ekspertë mjedisorë nga Shqipëria, ambientalistë, organizata të shoqërisë civile si Shoqata “Massmedia dhe Mjedi” , Mjaft, Co Plan, Shoqata për të drejtat e njeriut, etj. Paketa përmban gjithashtu dhe një koleksionin me 34 filma mjedisorë, nga të cilët 8 janë filma mjedisorë shqiptarë. Këta filma janë bërë të mundur në sajë të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga dhe Studio e Filmave Mjedisore “EkoZoom” - Shqipëri, “Television Trust for Environment” (TVE International) - Spanjë, Shoqata mjedisore “Borrowed Nature” – Bullgari, Televizioni dhe Qendra e Filmit e WWF. Ilustrimet dhe fotografitë e Paketës së Gjelbër janë frut i punës së mjaft artistëve dhe fotografëve nga Shqipëria, Hungaria dhe vende të tjera të Evropës.

## Libri i mësuesit

Libri i mësuesit është orientuar kryesisht për mësuesit dhe nxënësit e tyre. Elementi kryesor është Plani i Mësimit, por që rekomandohet të përdoret i kombinuar me komponentët e tjerë të Paketës së Gjelbër si filmat, CD dhe lojërat e dilemave. Çdonjëra prej temave mjedisore është e mbuluar nga një ose më shumë mësim. Planet mësimore janë menduar të tillë që të mund t’i sigurojnë përdoruesit informacion rreth koncepteve kryesore, çështjeve mjedisore, materialet e nevojshme, kohëzgjatjen e aktivitetit, vendin e zhvillimit, objektivat dhe metodologjinë e mësimit ose aktivitetit. Aktivitetet që përshkruhen në librin e mësuesit kanë një karakter udhëzues, më shumë se të detyrueshëm. Ata janë të orientuar për të zhvilluar imagjinatën e mësuesit në organizimin e aktiviteteve mjedisore të ngjashme



 Vendet që janë përfshirë në përgatitjen e Paketës së Gjelbër



Toyota Motor Europe (2003) u paraqit gjatë Konferencës së Pestë Ministeriale “Mjedisi për Evropën” në maj të vitit 2003 si dhe Iniciativës së Javës së Gjelbër të Komisionit Evropian në Bruksel në qershor 2003.

### Edukimi mbi zhvillimin e qëndrueshëm

Gjatë Konferencës së Pestë Ministeriale “Mjedisi për Evropën”, të zhvilluar në Kiev, maj 2003, nga qeveritë dhe OJF-të interes i konsiderueshëm iu kushtua përmirësimit të edukimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Konferenca propozoi nisma të reja në fusha të caktuara. Duke njohur rëndësinë e veçantë të edukimit mjedisor mbi zhvillimin e qëndrueshëm, REC dhe Toyota Motor Europe, organizuan, gjatë ditëve të kësaj konference, aktivitetin “Bashkëpunimi si parakusht për një edukim të suksesshëm në Zhvillimin e Qëndrueshëm”. Pjesëmarrësit shprehën mbështetjen e tyre që Edukimi mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, si një koncept i gjerë, me dimensione ekonomike, sociale, mjedisore të merret në konsideratë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Gjatë 2004 dhe në vijim, shumë vende po përgatisin kurrikula dhe materiale të veçanta edukuese në kuadër të kësaj nisme dhe asaj të Kombeve të Bashkuara për t’ia kushtuar dekadën e ardhme 2005-2015 Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

me ato të sugjeruara, por këto në përputhje me nevojat specifike të çdo rajoni si dhe me aftësitë e vetë nxënësve.

### Përmbajtja e CD-s

CD-ja është përgatitur, veçanërisht, për punën e mësuesit dhe edukatorëve, në fushën e edukimit mjedisor dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ajo siguron informacion të gjerë për të 22 temat kryesore, të cilat janë strukturuar si më poshtë: informacion i përgjithshëm mbi temën dhe përmbajtjen, cilat janë sfidat dhe si mund të kapërcehen problemet, disa raste studimore, si dhe çfarë mund të bëjë secili prej nesh në lidhje me to. Informacioni është i paraqitur me tekst, foto, harta, teste, tabela tërheqëse si dhe ilustrime, por duhen theksuar dhe videoklipet. CD-ja përmban gjithashtu dhe adresa interneti të faqeve mjedisore të ndryshme që trajtojnë po këto çështje. Plani i mësimëve është i njëjtë me atë të librit të mësuesit në format *pdf*, që mund të merren dhe përdoren si aktivitete në klasë.

### Filma mjedisorë

32 videoklipe, filma të shkurtër dokumentarë e edukativë (180 minuta), që gjenden në diskun DVD dhe që mund të përdoret në kompjuter apo në aparatura të tjera të përshtatshme, lidhen me 22 temat mjedisore siç paraqitet në tabelën përmbledhëse në fund të librit të mësuesit.



## Paketa e Gjelbër është bërë e mundur në saj të mbështetjes së Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, në kuadrin e programit “Bashkëpunimi Holandez për Zhvillim”

Buitenlandse Zaken

### Ontwikkelings samenwerking


Objektivi kryesor i Bashkëpunimit Holandez për Zhvillim është zbutja e varfërisë. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit janë metodat për të arritur këtë objektivi. Për të arritur këto qëllime, qeveria holandeze do të vazhdojë të akordojë 0,8% të GDP-së saj për bashkëpunim dhe zhvillim.

Programi dypalësh holandez për zhvillimin, në Shqipëri, fokusohet te qeverisja e mirë dhe mjedisi. Qeverisja e mirë është e nevojshme për të parandaluar konfliktet e dhunshme, për të ruajtur fuqinë e ligjit, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar që procesi i demokratizimit

të vazhdojë të funksionojë. Ai është, gjithashtu, një kusht paraprak për nxitjen e rritjes ekonomike dhe për të siguruar që rezultatet e kësaj rritje të shpërndahen në mënyrë të barabartë. Për më tepër, edukimi luan një rol thelbësor në përsheptimin e rritjes ekonomike. Edukimi i jep fëmijëve perspektivën e të ardhmes dhe ndikon në fuqizimin e tyre social, ekonomik dhe politik. Por – fëmijët duhet të rriten në një mjedis të shëndetshëm!

# Loja me dilemat


## mënyra për t'u shkathtësuar në mbrojtjen e mjedisit




Supozoni që ju jeni kryetari i bashkisë së qytetit tuaj. Ju jeni në dijeni se sasia e mbetjeve që prodhohen në qytetin tuaj është duke u rritur nga viti në vit. Ju keni vendosur t'i shkruani kryeministrit dhe i rekomandoni marrjen e masave të përshtatshme për zvogëlimin e mbetjeve të prodhuara. Cilën prej alternativave të mëposhtme do të propozonit ju?

- 1 Mbështetjen e përdorimit të teknologjive të pastra që prodhojnë më pak mbetje.
- 2 Zbatimin e programeve që nxisin publikun e gjerë për zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të tyre.
- 3 Shtimin e përdorimit të materialeve dhe lëndëve të para që janë të biodegradueshme.
- 4 Vendosijen e taksave për përdorimin e tepruar të ambalazhimeve dhe për të mirëmbajtur venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme.



Mbetjet 

Mbetjet 

Duke punuar me dilemat, në këtë lojë, mësuesit dhe nxënësit mund të përfshihen në një diskutim të thellë në çështje dhe aspekte të veçanta të mbrojtjes së mjedisit apo konfliktit me zhvillimin ekonomik. Kjo lojë ndihmon nxënësit në përgatitjen e tyre për respektimin e mendimit të tjetrit, kuptimin dhe arritjen e konsensusit. Prandaj, mësimi nëpërmjet lojës, një teknikë e kohëve moderne, po përhapet gjithnjë e më shumë për të krijuar qytetarë më të devotshëm nesër, më të përgjegjshëm dhe më praktikë në jetën e përditshme. Duke i angazhuar fëmijët në role të ndryshme si ai i kryetarit të Bashkisë që organizon konkurs për dhënien e ideve të reja për mënyrën se si mund të zgjidhet problemi i trafikut në rrugë, apo edhe i ndotjes së ajrit të shkaktuar në qendër të qytetit, jo vetëm që ata mësojnë se cilat janë detyrat e një kryetari bashkie, por edhe zhvillojnë fantazinë e tyre që të mendojnë vërtet si një kryetar bashkie, shembull për të tjerët.

Një tjetër rol interesant është ai i pronarit të fabrikës që ndot mjedisin. Fëmijët, nëpërmjet lojës me këtë dilemë, mësojnë të respektojnë rregullat e shoqërisë të vendosura dhe të sanksionuara me ligje konkrete, mësojnë se si duhet të përballohen situata sociale të caktuara dhe për më tepër mësojnë se edhe kur të rriten dhe mund të qëllojë që të jenë pronarë të një fabrike, të mos e ndotin mjedisin vetëm e vetëm sepse duhet të nxjerrin fitime. Ata mësojnë që të gjejnë alternativa të ndryshme për situata që do t'i përfshijnë në një mënyrë ose në një tjetër në të ardhmen e tyre.

**K**jo është vetëm një nga 22 rastet studimore, një për çdo temë mjedisore, të organizuara në formën e lojës së dilemës, pjesë e Paketës së Gjelbër. Temat mjedisore trajtojnë ato që na shqetësojnë çdo ditë, siç janë zhurmat, ajri, uji, mbetjet e rrezikshme, pyjet, detet dhe oqeanet, bujqësia, mbi të cilat pothuajse asnjëherë nuk diskutohet në familje, ndërsa, në shkollë, tekstet shkollore janë shumë të varfra në shembuj, ose në kuriozitete dhe aq më pak i vihet theksi rëndësisë së mbrojtjes së tyre. Tekste si biologjia apo dituria e natyrës, për vetë natyrën që kanë nuk mund të përmbajnë tema të zgjeruara në lidhje me degradimin e tokës, shkatërrimin e pyjeve, apo edhe rrezikun që shkaktojnë mbetjet si vajrat e makinave, apo produkte të tjera, nëse hidhen në natyrë, ujë ose groposen në tokë. Për këtë arsye, futja e orëve të veçanta të diskutimit në programin mësimor është parë një nga risitë më frytdhënëse për të gjithë komunitetin, që nga fëmija-nxënësi, deri te mësuesi, prindi dhe politikani i ardhshëm. Sa më i ndërgjegjshëm të jetë secili prej tyre për rëndësinë e të mësuarit për mjedisin, aq më e mirë do të jetë e ardhmja e të gjithëve. Nëpërmjet lojës së dilemave, secili prej rasteve studimore paraqet një situatë si dhe një numër zgjidhjesh të mundshme për situatën e paraqitur, si dhe komentet mbi aspektet pozitive e negative për çdo përgjigje.



# Fëmijët duan të edukohen mbi mjedisin

*Sondazhi i REC, gjatë marsit 2006, në 5 qytete kryesore, tregon vlerësimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare për mësimin praktik mbi mjedisin*




nëpërmjet edukimit mbi mjedisin. Praktika aktuale, që tenton të përfshijë në kurrikulën mësimore të shkollave, qoftë të nivelit parauniversitar, qoftë në ato të nivelit universitar dhe pasuniversitar dhe synon veçanërisht përhapjen e idesë se edukimi mjedisor është një domosdoshmëri që kërkohet nga vetë komuniteti. Rëndësia e këtij ndërgjegjësimi do të ndikonte konkretisht edhe në reduktimin e problemeve mjedisore, me të cilat secili prej nesh ndeshet në jetën e përditshme. Fëmijët e shkollave kanë listuar disa prej tyre siç janë ndotja e mjedisit nga automjetet, ushqimet e skaduara, shkatërrimi i mjediseve të gjelbra, ndërtimet pa leje, mjediset e papërshtatshme të grumbullimit të plehrave, zhurma e automjeteve, uji i ndotur nga ujërat e zeza, ndotja e tokës, ndotja e mjedisit nga fabrikat, radioaktiviteti, zhurmat nga gjeneratorët, prerja e drurëve pa kriter, mungesa e kontrollit të ushqimeve, kanalizimet jo të rregullta apo edhe mbetjet urbane industriale. Të gjitha këto probleme sigurisht që do të zvogëloheshin nëse ndërgjegjësimi për vlerën e pakthyeshme të mjedisit të niste që në bankat e shkollës, pse jo edhe në kopshte.

Fëmijët e shkollave nëntëvjeçare janë pyetur, në fillim të këtij viti, në lidhje me rëndësinë që mund të ketë edukimi mjedisor në përmirësimin e jetës së tyre, shëndetit, si dhe në zvogëlimin e aksidenteve që rrezikojnë jetën e tyre. Mbi 400 fëmijë të disa shkollave kryesore, në 5 qytete të mëdha siç janë Tirana, Shkodra, Vlora, Pogradeci, Elbasani, gjatë muajit mars të këtij viti, kanë plotësuar një pyetësor të përgatitur nga REC Shqipëri. Ata vlerësojnë edukimin mjedisor të fëmijëve dhe prindërve si një nga arsyet më të rëndësishme që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të tyre. Pyetja që u është bërë fëmijëve në fakt ka pasur qëllim vlerësimin me anën e një shkalle nga 1 deri te 5, ku 5 është vlerësimi maksimal, duke zgjedhur atë alternativë nga shtatë të dhëna që ata mendojnë se është më e vlefshme. Edhe pse ngritja e mjediseve sportive dhe pajisja e oborreve të shkollave dhe kopshteve me pemë dhe lule janë renditur si alternativat më të mira, me respektivisht 718 pikë dhe 712

pikë, edukimi mjedisor i fëmijëve dhe prindërve është po aq i ndjeshëm nga ana e komunitetit dhe zë një vend të veçantë në sondazh. Duke u nisur nga fakti se edhe vetë fëmijët e shohin edukimin mbi mjedisin si një zgjidhje të problemeve që kanë lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor dhe me vetë ndikimin që ai ka në jetën tonë të përditshme, është e nevojshme që fokusi të drejtohet pikërisht në këtë fushë, pra atë të ndërgjegjësimit

**Kush nga zgjidhjet e mëposhtme do të ndikonte më shumë në përmirësimin e shëndetit të fëmijëve si dhe në zvogëlimin e aksidenteve që rrezikojnë jetën e tyre?**



# Nevoja për Edukimin Mjedisor

## Përvoja dhe opinione të edukatorëve

### Klubi mjedisor, klubi i ideve

Klubet mjedisore dhe edukimi mbi mjedisin në shkolla të ndryshme të vendit kanë dhënë frutet e tyre. Përvoja e mësueseve që kanë punuar me nxënës të shkollave të mesme ka treguar se edukimi nëpërmjet punës për shumë të rinj ka qenë një shtysë e madhe dhe një ndryshim i mentalitetit të tyre. Interesante është puna që grupi ekologjik i shkollës “Çajupi” në kryeqytet ka zhvilluar që prej prillit të vitit 1998, kur edhe është themeluar. Aktivitetet kanë pasur si qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve me problemet e mjedisit dhe me edukimin ciklik, më konkretisht të rinjtë për të rinjtë, të rinjtë edukojnë prindërit e tyre, të rinjtë ndikojnë në komunitet, duke filluar me klasën dhe shkollën ku mësojnë, në shtëpitë, lagjet, apo qytetin ku jetojnë.



### Në shkollën “Çajupi”

Ina Kasimati, mësuesja e kësaj shkolle, njëkohësisht edhe drejtuese e grupit ekologjik të shkollës tregon se eksperiencia tetëvjeçare në këtë klub u ka mësuar nxënësve të jenë më të përgjegjshëm. “Kanë mësuar të jenë qytetarë më aktivë në ndryshimet ndaj mjedisit, por edhe në hartimin e ligjeve dhe konventave në dobi të shëndetit dhe jetës së fëmijëve. Këto ditë kanë filluar të përfshihen në ekspedita mjedisore në ditët e fundjavave të tetorit dhe nëntorit për të njohur eksploruar prezantuar vlerat turistike të Tiranës”, thotë Kasimati. Orët mësimore praktike kanë pasur në thelb tema të tilla si, mënyra e llogaritjes së shpenzimit dhe kursimit të energjisë elektrike në shtëpi nëpërmjet përdorimit të llampave ekonomike, realizimi i konkurseve me projekt ide, me postera dhe me monitorime, panairë për mbrojtjen e mjedisit, riciklimin e lëndëve, për përdorimin e ushqimeve të shëndetshme dhe rregullimin e ambienteve me lule. Kasimati tregon se në vitet e kaluara në këto programe përfshiheshin nxënësit që ishin anëtarë të klubit. Kjo gjë tashmë ka ndryshuar. “Rezultatet qenë mjaft interesante, pasi ky edukim ka përfshirë nxënës që ndoshta nuk paraqesin në aparencë interes për shkollën. Në këtë orë mësimi dhe aktivitetet e klubit ata kanë qenë mjaft aktivë dhe kanë nxjerrë në pah edhe vlerat më të mira, siç është puna në grup, mentaliteti i ndryshuar ndaj qëndrimeve në çështje të tilla si dhe kanë arritur që t’i shndërrojnë këto aktivitete në lidhje sociale”, thotë Kasimati.

### Mjedisi, pjesë e fortë e ndërgjegjes qytetare të secilit

*Tefta Musta, shkolla “Ali Demi” Vlorë*

“E kërkojmë mjedisin, ëndërrojmë gjithë kohën bukurinë dhe dobinë e tij nëpër vende të veçanta apo në reklama televizive plot ngjyra dhe harrojmë që mjedisin e kemi këtu, sapo hapim derën e shtëpisë”. Aty te rrugica e secilit prej nesh nis mjedisi. Dhe është e thjeshtë të kujdesesh për të: mjaft të hedhësh qesen e plehrave në koshin më të afërt, mjaft të kujdesesh për lulet dhe pemët e shtëpisë apo institucionit ku punon, mjaft të mos presësh asnjë pemë nga sipërfaqja e qytetit apo pallatit, mjaft që asnjë qeveritar të mos bëjë investime të rrezikshme për mjedisin. Pra, mjedisi duhet të jetë pjesë e fortë e ndërgjegjes qytetare të secilit njeri, sepse është pjesë e fortë e vetë jetës. Dhe, si çdo gjë në jetë që jeton vetëm përmes dashurisë, edhe mjedisi do të mbijetojë vetëm përmes saj.

### Paketa e gjelbër, ideale për punën e mësuesit

*Shefqet Khanari, shkolla private “Dituria”*

Paketa e Gjelbër është shumë e nevojshme, e theksuar kjo për kushtet tonë ku njerëzit vlerësojnë më shumë veprimtaritë që çojnë në rritjen e standardit të jetesës dhe duke anashkaluar apo mosvlerësuar fare problemet mjedisore. Edukimi mjedisor në shkollën 9-vjeçare është domosdoshmëri, madje do të ishte shumë mirë që të fillonte në arsimin fillor. Nxënësit e ciklit të fillores për moshën që kanë, i marrin seriozisht temat për edukimin mjedisor dhe janë kërkues për aplikimin e tyre. Nxënësit e fillores janë si një fletë e bardhë në të cilën mbetet ajo që shkruhet dhe aty duhet investuar. Paketa i përmban dhe i trajton pothuajse të gjitha problemet mjedisore dhe në këtë drejtim është një material mjaft i kompletuar dhe shumë i dobishëm. Mësuesit kanë si detyrë vetëm t’i aplikojnë në punën me nxënësit. Edukimi mjedisor mund të përfshihet në të gjitha lëndët, por në veçanti në biologji, dituri natyre, kimi e më pas në gjeografi, edukatë qytetare etj. E thjeshtëzuar paketa mund të zhvillohet edhe me nxënësit e fillores, duke theksuar se është një gjë shumë pozitive, me të cilët ndoshta është edhe më e thjeshtë të gjendet koha se kur duhet bërë.

## Kanë thënë për...



Zhvillimet ekonomike-sociale në Shqipëri, në këto 15 vite, kanë zgjeruar spektrin e problemeve mjedisore, të cilat tashmë janë të pranishme kudo: në qytete, fshatra, lumenj, liqene, bregdet, në pyje e laguna, përfshirë dhe zonat e mbrojtura. Ky realitet ka në sfond edhe probleme mjedisore të trashëguara, që, në shumicën e rasteve, janë identifikuar si vatra të nxehta mjedisore. Për eliminimin ose zbutjen e këtyre problemeve është punuar dhe punohet nga institucione të qeverisjes qendrore dhe vendore, institucione kërkimore-shkencore, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Po krijohet një shtrat solid ligjor dhe institucional për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, i cili do ta administrojë në mënyrë më efektive. Në këtë proces, vend parësor zë edhe niveli i ndërgjegjësimit të njeriut, dhe në këtë kontekst, pjesëmarrja e tij në zgjidhjen e problemeve mjedisore. “Paketa e gjelbër”, me larminë e mjeteve të thjeshta dhe tërheqëse që u ofron fëmijëve dhe të rinjve, do të ndihmojë në edukimin mjedisor të tyre. Vazhdimësia dhe përsosja e formave të edukimit mjedisor, do të kontribuojë në përpjekjet për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.

**Prof. Dr. Lirim Selfo**  
ekspert mjedisi

Të gjithë faktorët biotikë, si: organizmat e gjallë, ushqimet e tyre dhe ndërveprimet midis tyre si dhe me mjedisin jo të gjallë, së bashku me faktorët abiotikë, si: moti e klima, hapësira jetësore dhe trualli, përbëjnë mjedisin e plotë ku jetojnë të gjitha gjallesat. Natyra, pra dhe mjedisi janë burim të mirash materiale për sigurimin e jetesës e të zhvillimit. Falë natyrës ne jemi gjallë dhe përmes saj njerëzimi ka mbijetuar kaq gjatë e ka arritur nivele të jashtëzakonshme zhvillimi. Por natyra e mjedisi janë gjithashtu burim i pazëvendësueshëm pasurie shpirtërore për të gjithë ne. Nuk ka pra as edhe një element të jetës materiale a shpirtërore të njerëzimit që të jetë tërësisht i shkëputur e i pavarur nga natyra. Ndaj ruajtja e mbrojtja e

mjedisit ku jetojnë të gjitha gjallesat është detyrë parësore për të gjithë brezat. Lidhur me këtë, arsimimi mjedisor e për zhvillimin e qëndrueshëm po luan rol gjithnjë e më të rëndësishëm në përballimin e thirrjeve që shfaqen në nivel kombëtar e rruzullor....

**Prof. Dr. Dhimitër Haxhimihali,**  
Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore

Në ende jemi të verbër përballë forcave të reja, që mund të rrezikojnë të ardhmen tonë. Por një gjë tashmë e dimë: E ardhmja jonë kërcënohet nga pasiguria mjedisore. Prandaj, për shoqërinë tonë, është koha të mbjellë kulturën mjedisore. “Paketa e Gjelbër” është si një fidanishte e shoqërisë së ardhme, që do të përballet me sfidat e reja mjedisore. Ky edukator i mirë mjedisor bën që, aty ku ka pasur një qytetar mbrojtës të mjedisit, të lindin mijëra të tillë, aty ku ka pasur një ide për zhvillimin tonë në harmoni me natyrën, të lindin qindra të tilla, pra ajo mbjell në vendin tonë shpresën për një vend natyror të sigurt, të qëndrueshëm dhe produktiv.

**Xhemal Mato,**  
Drejtor i Qendrës “Ekolëvizja”

Sot është bërë më se e qartë që problemet mjedisore, ndonëse ndjehen lokalisht, janë çështje globale. Në kuadër të kësaj “pakete”, ne jemi përpjekur të paraqesim këto sfida globale mjedisore, shpesh mjaft komplekse, dhe të tregojmë se si ato lidhen me Shqipërinë, Evropën, planetin dhe banorët e tij. Shpjegimi i informacionit mjedisor për mësuesit – dhe nëpërmjet tyre dhe për nxënësit – është synimi themelor i Paketës së Gjelbër. Ne duam të tregojmë, në një mënyrë të qartë, se si ne të gjithë jemi pjesë e mjedisit dhe se si veprimet tona ndikojnë në të. Informacioni i kuptueshëm mjedisor – dhe njohuritë që përcjell ai – është kyçi që na lejon për të marrë vendime se si ne do t'i jetojmë jetët tona dhe të vendosim prioritetet që vendet tona duhet të ndjekin. Paketa e Gjelbër është një mjet për mësuesit dhe nxënësit për të filluar të kuptojnë këtë ide. Kjo, me shpresë, do të çojë në një rrugë ku gabimet e të kaluarës do të shmangen nga brezat që do të vijnë.

**Robert Atkinson,**  
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)  
për Evropën Qendrore e Lindore  
Szentendre, Hungari

Të gjithë lindin, rriten, zhvillohen dhe vdesin në mjedis, “shtëpinë e përbashkët”.

Ajo duhet pastruar, mbrojtur e ruajtur me dashuri. Që të dashurohet duhet të njihet nga të gjithë. Pikërisht këtë synon të realizojë Paketa e Gjelbër.

**Prof. Dr. Liri Dinga**  
Kopshti Botanik, Tiranë

# (SEARCH)

Shkolla, Mjedi dhe Shëndeti i Aparatit të Frymëmarrjes të Fëmijët  
Një projekt ndërkombëtar kërkimor



Në vijim të projektit italiano – hungarez për cilësinë e ajrit të mjedisve të mbyllura vjen një zhvillim i ri në bashkëpunimin ndërmjet 8 shteteve: Shqipëri, Austri, Bosnje-Hercegovinë, Hungari, Itali, Norvegji, Serbi-Mali i Zi dhe Sllovakia, lidhur me këtë çështje.

## Fokusi kryesor i projektit

1. Zbatimi i Planit të Veprimit, të Strategjisë Europiane për Shëndetin dhe Mjedisin dhe të CEHAP nëpërmjet përfshirjes aktive në proceset europiane dhe përgatitjes së instrumentave dhe mjeteve efçente në bashkëpunimin ndër-institucional.
2. Pjesëmarrja rajonale në zbatimin e Qëllimit Prioritar 3 të CEHAP: Parandalimi dhe reduktimi i sëmundjeve respiratore që shkaktohen nga ajri i jashtëm dhe ai i mjedisve të brendshme nëpërmjet kërkimeve komplekse në shkollat e përfshira.

## Objektivat

1. Të vlerësojë marrëdhëniet ndërmjet mjedisit në shkolla dhe shëndetit (respirator) të fëmijëve;
2. Të japë rekomandimet e duhura për përmirësimin e kushteve mjedisore në shkolla.

## Pjesët e studimit

1. Vlerësimi i ekspozimit
  - a. Matja e cilësisë së ajrit të mjedisve të brendshme nëpër shkolla;
  - b. Pyetësorë mbi ndërtimin e shkollave dhe mirëmbajtjen e tyre;
  - c. Pyetësorë mbi mjedisin në shtëpi.
2. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të fëmijëve
  - a. pyetësorë për simptomat;
  - b. matja e funksionimit të mushkërive;
  - c. testi i ndotjes së hundës.

Projekti do të përfshijë të paktën 10 shkolla në secilin shtet dhe planifikon të marrë në analizë jo më pak se 100 nxënës në secilën shkollë

# Mund të bëhen nxënësit aktivë për mbrojtjen e mjedisit?

Nga Lindita Bushati - Mësuese e shkollës së mesme "28 Nëntori" Shkodër



**K**onceptet mbi mbrojtjen e mjedisit kanë evoluar shumë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Në fillim lindi mendimi për mbrojtjen e natyrës, meqenëse disa lloje po zhdukeshin dhe disa rajone duheshin mbrojtur, sepse po shkatërroheshin. Kjo ide ishte e pamundur të realizohej në kushtet kur njerëzit ende vazhdonin të ndotnin mjedisin. Ndaj lindi mendimi për mbrojtjen e mjedisit. Pastaj, njerëzit arritën në përfundimin se kontrolli i ndotësve nuk ishte i mjaftueshëm. Ai duhej shoqëruar me menaxhim racional të të gjithë burimeve natyrore. Evolucioni i mendimit njerëzor tregon se njerëzit synonin të integronin disa faktorë. Për shembull, ideja klasike e mbrojtjes së natyrës, përfshinte mbrojtjen e disa llojeve dhe zonave natyrore të caktuara; mbrojtja e mjedisit e vendos atë në plan të parë, ndërsa menaxhimi i burimeve natyrore në përputhje me kriteret ekologjike, integron mjedisin dhe ekonominë. Kjo çoi dalëngadalë në idenë e zhvillimit të qëndrueshëm, e cila përmbledh tre faktorë: mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë.

Zhvillimi i qëndrueshëm paraqet mendim më të evoluar, i shoqëruar edhe me përpjekje për ta vënë atë në praktikë.

Ekzistenca e njeriut mbështetet fuqimisht në përdorimin e kujdesshëm dhe në mbrojtjen e burimeve natyrore. Por deri më sot, natyra është parë vetëm si mjet për t'u shfrytëzuar dhe për të nxjerrë fitime. Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe shkatërrimi i natyrës është aq i madh, saqë pasojat e këtij shkatërrimi vërehen në shkallë botërore.

Një rol të madh në rritjen e numrit të organizatave të ndryshme që punojnë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe të anëtarëve aktivë luajnë nxënësit dhe studentët, të cilët, në shumicën e rasteve, përbëjnë pjesën më të ndërgjegjësuar e më të përparuar të kombit, me ide dhe frymëzime të reja për të ardhmen.

## Si mund të bëhesh aktiv

Shpesh herë ndodh që të bëhesh aktiv edhe rastësisht. Kështu njerëzit bëhen aktivë në një grup shoqëror nga bindjet intelektuale, politike, fetare, sociale, ose nga njohjet me shokët apo nga përvojat pozitive që disa nga ne kanë nga pjesëmarrja në një organizatë ose klub.

### 1. Arsye ideologjike

Reflektojnë atë çka njerëzit duan të ndryshojnë në shoqëri përmes pjesëmarrjes të drejtpërdrejtë.

### 2. Arsye personale

Mund të përfshijnë parapëlqimin për të punuar me persona të caktuar si dhe parapëlqimin për të qenë anëtar i këtij grupi

### 3. Arsye praktike

Këtu mund të bëjë pjesë përfitimi material, mundësia e mësimit dhe përdorimit të kompjuterit

Për të zhvilluar një aktivitet është e domosdoshme pjesëmarrja e njerëzve. Jo rrallë herë është e vështirë të grumbullosh një numër të madh njerëzish. Të qenit aktiv në një organizatë përbën në vetvete një konkurrencë me shumë gjëra të tjera që mund të bësh gjatë kohës së lirë.

## Shkolla dhe organizimet e nxënësve dhe mësuesve në to

Nisur nga ndërgjegjësimi për problemet e mjedisit, shtytja për të organizuar diçka të re dhe thyer monotoninë e zakonshme, shumë nxënës janë organizuar dhe kanë krijuar klubin mjedisor të shkollës. Mundësitë e krijuara për argëtim lejojnë që aktivitetet në natyrë ose me komunitetin të bëhen shumë tërheqëse, nëse organizohen bukur dhe përfshijnë një numër të gjerë nxënësish, mësuesish, prindërisht, etj. Binjakëzimet ose degët e ngritura në kuadër të klubit mjedisor forcojnë lidhjet jo vetëm brenda saj, por edhe me gjerë. Klubet mjedisore në shkolla ose shoqatat rinore janë bërë nismëtare për shumë aktivitete, me tematikë zhvillimin e qëndrueshëm. Nxënësit e gjimnazit "28 Nëntori" kanë zhvilluar mjaft aktivitete ku kanë mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.



## Raporti i BE për produktet me ndikim të lartë në mjedis

Komisioni Evropian ka publikuar një raport duke treguar produktet që mbartin një rrezik të madh mjedisor që përdoren në BE. Publikimi i raportit shënon fundin e fazës së parë të një projekti kyç të nxjerrë mbi Politikën e Produkteve të Integruara të BE (IPP). Por politika të reja për të mbajtur nën kontroll ndikimet mjedisore lidhur me këto produkte, mund të rrjedhin nga ky proces. Komisioni tashmë është në proces duke mbledhur më shumë detaje të studiuar në tre fushat me më shumë ndikim: ushqime dhe pije, transport dhe banesa. Ky studim do të përqendrohet në vlerësimin potencial në secilën fushë. Sipas raportit, të njohur si *Eipro*, tre fushat më me shumë ndikim, që konsiderohen të tilla vetëm për rreth një të pestën e 283 grupeve të produkteve të analizuara, sot përfaqësojnë 70-80% e ndikimit të përgjithshëm nga përdorimi i tyre në vendet e BE. Produktet ushqimore dhe pijet përfaqësojnë vetëm 30% të ndikimit total. Fusha të tjera të përdorimit (konsumit) kanë ndikim shumë më të ulët, megjithëse ndonjë në rang më të lartë se të tjerët. Për shembull, restorantet dhe hotelet janë përshkruar si kontribues të “rëndësishëm” në ngrohjen globale, acidifikimin dhe eutrofikimin, por raporti thotë që nevojiten të dhëna të tjera për të pasur një pasqyrë më të plotë. Raporti rendit, gjithashtu, produktet sipas ndikimit të tyre në mjedis për çdo euro të harxhuar. Sigurisht që në majë do të qëndrojnë aktivitete të tilla si: pularitë, fabrikat e sallamit, makinat private, pajisjet elektrike si dhe sektori që mbulon ngrohjen e ambienteve të banimit.

Për më shumë informacion:  
<http://europa.eu.int>

## Pse duhet edukimi mjedisor?

Sigurisht një arsye mjaft e rëndësishme është sepse edukimi mjedisor është një çështje kritike për sigurimin e cilësisë së jetës. Edhe nëse flasim për shkatërrimet e pyjeve tropikale, ngrohjen globale, rrezikun ndaj mbetjeve toksike, krizën e oqeanëve apo cilësinë e ajrit – edukimi mjedisor është thelbësor nëse ne na kërkohet që të marrim pjesë plotësisht në zgjidhjen e problemeve mjedisore me të cilat përballet bota sot dhe që do të ketë të bëjë edhe në të ardhmen. Ka gjithashtu edhe shumë pasoja të tjera pozitive në çështjet e edukimit.

Edukimi mjedisor:

- u ofron edukatorëve një mënyrë më efektive për t'u integruar me kurrikulën;
- zhvillon aftësi kreative dhe kritike të të menduarit;
- jo vetëm mëson por edhe lejon nxënësit që të zhvillojnë aftësitë e tyre në zgjidhjen e problemeve;
- është shumë i përshtatshëm për të zbuluar sjelljet dhe eksploruar vlerat ndërkulturore;
- angazhon inteligjencën –sidomos natyralizmin;
- përfshin nxënësit në komunitetin e tyre;
- përdor strategjitë e mësimdhënies që vënë nxënësin në qendër të punës dhe të procesit të mësimnxënies.
- thekson faktin se kërkimi dhe aftësitë investigative ndihmojnë në kuptimin e përfshirjes së çështjeve sociale dhe ekonomike që fshihen pas atyre mjedisore
- lejon mësuesit që të integrojnë shumë prej parimeve të reformës në edukim: aplikime të botës reale, mësim në grupe mësimi dhe të kuptuarit, thekson konceptet, procesin dhe produktet vetëm si kundërshtare të përmbajtjes.

Më e rëndësishmja nga të gjitha është se kjo mënyrë thekson shkathhtësinë në jetën e përditshme që nxënësit duhet të përdorin në punën e tyre të mëvonshme dhe gjatë gjithë jetës së tyre.

Duke inkurajuar përfshirjen komunitare dhe përgjegjësinë sociale, nxënësit mësojnë se si të krijojnë ndryshime pozitive në komunitetin e tyre. Ata kanë mundësinë që të mësojnë por edhe të jenë një zë i rëndësishëm në botë.

<http://www.newhorizons.org>

<http://www.newhorizons.org/strategies/environmental/evans.htm>

## Kombet e Bashkuara do të studiojnë mjedisin në Liban

Një grup ekspertësh, koordinuar nga Kombet e Bashkuara, do të fillojnë një hetim lidhur me faktin se si konflikti më i fundit me Izraelin ka dëmtuar mjedisin në Liban. Grupi do të përqendrohet te derdhjet e naftës përgjatë vijës bregdetare të Libanit, shkaktuar nga bombardimi i një uzine energjetike, në ndotjen e rezervave ujore dhe në artilerinë e pashpërthyer. Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP) e ka mbledhur këtë grup me kërkesë të qeverisë libaneze. Nafta e uzinës energjetike *Jjyyeh*, e bombarduar gjatë korrikut, ka ndotur rreth 140 km bregdet. Rreth 10.000 - 30.000 ton naftë ka kaluar në Mesdhe. Po të bëjmë një krahasim, derdhja e naftës, në vitin 1998, nga “*Exxon Valdez*”, në Alaskë, arriti në 40.000 ton.

Për më shumë informacion:

<http://news.bbc.co.uk/2/hi/science/nature/5400382.stm>

# Të mbjellim sot fidanët e një të ardhmeje të qëndrueshme

*për të transmetuar njohuritë  
për të zhvilluar aftësitë  
për të kultivuar vlerat*

*për një të ardhme të qëndrueshme*



## Paketa e Gjelbër

*„është një mjet për të kuptuar në mënyrë të qartë, se si ne të gjithë  
jemi pjesë e mjedisit dhe se si veprimet tona ndikojnë në të...”*

